

**UNDEF**

The United Nations  
Democracy Fund



**FNUD**

Fonds des Nations Unies  
pour la démocratie



**Raport mbi realizimin e  
premtimeve elektorale të  
z. Mark Babani, Kryetari i  
Bashkisë Vau i Dejës**

**PROJEKTI**

**“Ndjekja dhe verifikimi i  
premtimeve të fushatës  
zgjedhore në Shqipëri”**

**Mbështetur nga:**

**Fondi për Demokraci i Kombeve të  
Bashkuara**

Për më tepër informacion vizitoni platformën online “Matësi Elektorale” (The Albanian Truth-o-Meter Platform):

[www.matesielektor.al](http://www.matesielektor.al)

Ju mirëpresim të kontribuoni me ide dhe sugjerime mbi shpenzimet/investimet buxhetore lokale apo të qeverisjes qendrore si dhe mbi premtimet elektorale të realizuara ose të parealizuara të të zgjedhurve lokalë dhe anëtarëve të qeverisë.

E-mail: [rdakorca@gmail.com](mailto:rdakorca@gmail.com)

Tel: + (355) 822 42626

## **Premtimet elektorale të z. Mark Babani, Kryetari i Bashkisë Vau i Dejës**

1. Në tre muajt e parë të mandatit tonë, ne do të kryejmë ndërhyrjet më emergjentë në infrastrukturë.
2. Iniciativa që kam marrë është të zhvillojmë bujqësinë si në të gjithë Europën. Zona e Barbullushit, dhe pjesë e malit të Jushit dhe Trushit janë hambari i bashkisë sonë për drithëra dhe prodhime bujqësie ka problematikë përmytjen dhe masa e parë që do marrim është pjesa e kullimit dhe vaditjes që janë kryesore për zhvillimin e zonës.
3. Duhet një planifikim i mirë i fermave blegtorale se ku duhen ndërtuar. Kemi zona të përkryera për frutikulturë. Të rinjtë tanë punojnë në Torino me frutikulturën, kanë eksperiencën që mund ta aplikojnë në tokat tona, për të nxitur rritjen e punësimit në zonë, duke shfrytëzuar potencialet natyrore të zonës.
4. Sot Laçi i Vaut të Dejës është një qytet që vetëm i tillë nuk mund të quhet. Mundësia e punësimit në këtë qytet është e pamundur, kjo popullsi do të punësohet ose në bashki, ose në ndërmarrjet shtetërore.
5. Liqenin do ta bëjmë të lundrueshëm, sepse turizmi kështu do të pësojë rritje. Nëse në fshatrat e vjetër si Lisna, Karma, rikonstruktojmë shtëpите e braktisura, ne kemi mundësinë që gradualisht t’ju krijojmë shpresën banorëve me këto lloj biznesesh turistike.

*Burimi: <https://ata.gov.al/2019/06/21/babani-shfrytezim-potencialit-te-zones-se-vaut-te-dejes-ne-funksion-te-rritjes-ekonomike/>*

## **Premtimet e arritura**

1. Riparimi dhe zëvendësimi i llampave ndriçuese të të gjitha dritave ekzistuese në qytetin Vau i Dejës.
2. Pastrimi i kanalit të dytë kullues me gjatësi prej 1700 ml në fshatin Kosmaç, Nj. Adm. Bushat.
3. Pastrimi i kanalit kullues me gjatësi 3000 ml në fshatin Rranxa, Nj. Adm. Bushat.
4. Pastrimi i kanalit të dytë kullues me gjatësi 3 km, që shtrihet nga fshati Ashtë deri në qendër të fshatit Kosmaç, Nj. Adm. Kosmaç.
5. Shtrimi me asfalt i rrugës prej 1.5 km, që lidh fshatrat Bushat, Mali i Jushit, Rranxa dhe Barbullush me rrugën e Velipojës.
6. Asfaltimi dhe ndriçimi i rrugës që lidh lagjen e Muçëjanve me rrugën e Pallateve, Nj. Adm. Bushat.
7. Sistemimi i hapësirës publike në sheshin Nënë Tereza, me vendosjen e piketave të betonit, stola pushimi si dhe kosha për hedhjen e mbeturinave.
8. Pastrimi i përroit sipër dhe poshtë, hapja e kanaleve kulluese dhe zgjerimi i parkingut tek varrezat e lagjes “Park” në qytetin Vau i Dejës.
9. Riparimi i kanalit të dytë kullues që mbledh ujërat e bardha, në hyrje të pedonale, sipër katedrales “Nënë Tereza”, në qytetin Vau i Dejës.
10. Riparimi dhe vendosja e pajisjeve të reja ndriçuese në të gjitha lagjet kryesore të fshatit Kaç, Nj. Adm. Vau i Dejës.

11. Ka përfunduar projekti për zëvendësimin e çatave prej eterniteti kancerogjen, në tjegulla të banesave dhe ndriçimit të plotë në lagjen “Kinoklubi”. Së fundmi është bërë dhe sistemimi i vendparkimit për automjetet në këtë lagje të qytetit Vau i Dejës.
12. Rehabilitimi i kanalit dytësor dhe rikthimi i funksionit natyral të tij për vaditjen e fushës në fshatin Melgush, Nj. Adm. Bushat.
13. Hapja, thellimi dhe krijimi i argjinaturës mbrojtëse në përroin që përshkon lagjen “Kapedan”.
14. Ndriçimi i gjithë rrugicave kryesore, nëpërmjet vendosjes së llampave të reja dhe riparimit të disa prej atyre ekzistuese, në fshatin Shelqet, Nj. Adm. Vau – Dejës.
15. Restaurimi i plotë i shkollës 9 – vjeçare në fshatin Naraç, Nj. Adm. Vau i Dejës. Ndërhyrja përfshiu rehabilitimin e ambienteve të brendshme dyer, dritare, sistemin e ri elektrik dhe hidraulik, suvatimet, rrethimi i ambientit të jashtëm të shkolles, krijimi i hapësirave sportive si fusha e futbollit, basketbollit etj.
16. Pastrimi i mbetjeve inerte të hedhura pa kriter në hyrje të qytetit Vau i Dejës.
17. Vendosje e ndriçimit publik në të gjitha rrugët kryesore të fshatit Plezhë, Nj. Adm. Bushat.
18. Vendosje e ndriçimit publik në të gjithë territorin e fshatit Ashë, Nj. Adm. Bushat.
19. Hapja dhe sistemimi i kanaleve kulluese në fshatin Nënshat, Nj. Adm. Hajmel.
20. Vendosja e ndriçimit publik në rrugët kryesore të fshatit Pistull dhe në fshatin Dheu i Lehtë, Nj. Adm. Hajmel.
21. Instalimi i ndriçimit publik në të gjithë territorin e fshatit Spathar, Nj. Adm. Vau i Dejës.
22. Rehabilitimi i kanalit të parë vaditës në fshatin Mjedë, Nj. Adm. Vau i Dejës.
23. Përfundon ujësjellësi i ri prej 22.6 km rrjet shpërndarës që do të sigurojë ujë 24 orë për çdo shtëpi të Vaut të Dejës.
24. Pastrimi i kanaleve vaditëse dhe kulluese Shelqet – Stajkë, Nënshat, Shkvezë, Rranxa dhe Barbullush me një gjatësi totale prej 8 km kanale të treta kulluese, 30 km kanale të dyta kulluese, 12 kanale të dyta vaditëse si dhe pastrimi i kolektorit kryesor vaditës Shelqet-Stajkë.

### **Premtime pjesërisht të arritura (në proces)**

1. Pas lirimit të hapësirave publike, ka filluar puna për ndërtimin e parkut për banorët e lagjes “Dy katëshet” dhe pallateve në qytetin e Vaut të Dejës.
2. Pas përfundimit të fazës së parë të pastrimit të kanaleve kulluese dhe vaditëse në fshatrat e Bashkisë Vau Dejës, ka filluar puna për betonizimin e tyre në mënyrë që ti japim një zgjidhje përfundimtare pastrimit të kanaleve vaditëse vit pas viti.

*Burimi: <https://www.facebook.com/markbabaniel>*